



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

SHESHI "NËNË TEREZA", REKTORATI I UT-së, TIRANË
TEL. +4 2228402, FAX: +4 223981

VENDIM

Nr.22 datë 26.09.2016

"Për miratimin e kritereve të pranimit në programet e studimeve të ciklit të dytë në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2016-2017"

Bazuar në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH"* neni 3 pika 4 gërma b), neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 37 pikat 1 e 2, neni 38 pika 1 gërma a) e neni 76; në *Statutin e Universitetit të Tiranës* neni 19 pika 2 e neni 49 pika 2; si dhe në propozimet e përcjella nga njësitë kryesore, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 26.09.2016;

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit për programet e studimeve të ciklit të dytë, si më poshtë:
 - a- Kandidatët të kenë përfunduar një program studimi të ciklit të parë ose një program studimi ekuivalent me të sipas përcaktimeve të ligjit nr.80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH"*.
 - b- Kandidatët të plotësojnë kriteret e tjera specifike të përcaktuara nga çdo njësi kryesore sipas programeve të studimeve, të detajuara në tabelën bashkëlidhur.
 - c- Përparësi kanë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në Universitetin e Tiranës.
2. Për kandidatët që aplikojnë në programet e studimit të ciklit të dytë *"Master i shkencave"* përveç kritereve të përcaktuara më sipër, kandidatët duhet të kenë njohje të një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, në nivelin B1 sipas Vendimit të Senatit Akademik të UT nr.18, datë 13.07.2016.
3. Përzgjedhja e kandidatëve fitues të bëhet sipas rendit zbritës të notës mesatare të ponderuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
MYNYR KONI